

Skënder Rizaj

JETA DHE VEPRIMTARIA POLITIKO-PATRIOTIKE E ABDYL FRASHËRIT DERI TE KONGRESI I BERLINIT (1878)

Abdyl Frashëri (1839—1892) lindi në shtëpi të Dulellarëve në Frashër¹ nga prindërit Halid Frashëri (1797—1859) dhe Emine Mirahori (1814—1861). Ishin gjashtë vëllezër dhe dy motra: Abdyl, Nefiseja (1841—1894), Sherifi (1843—1874), Naimi (1846—1900), Shahnishaja (1848—1871), Samiu (1850—1904), Tahsini (1853—1876), Mehmeti (1856—1918).²

Është një dukuri jo aq e zakonshme që nga gjiri i një familjeje të dalin tre pishtarë, tre flamurtarë, tre patriotë të flaktë, siç ishin tre vëllezërit Frashëri — Abdyl, Naimi dhe Samiu. Këta luftuan me vetëmohim të plotë dhe me fuqinë e tyre morale, intelektuale, politike, letrare dhe shkencore për të mirën e atdheut dhe të kombit të tyre, për të mirën, pra, të Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Luftuan për çlirimin e Shqipërisë dhe për bashkimin e trojeve të saj, luftuan për çlirimin dhe përparimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Shqipërisë, mu në kohën kur ajo ishte më së shumti e rrezikuar.

Duhet të vëmë në pah edhe një dukuri lidhur me jetën e këtyre tre pishtarëve Frashëri. Abdyl, Naimi dhe Samiu jetuan vetëm nga 53—54 vjet dhe i ndoqën mësimet e mesme në gjimnazin „Zosimea” në Janinë. Vdiqën të tre pishtarët shqiptarë në moshën më të mirë për luftë e për punë, vdiqën në moshë relativisht të re, vdiqën në moshën 54-vjeçare për arsye se jetuan

¹ Frashëri është një fshat i madh ose një qytet i vogël. Gjendet në Shqipëri. Është një vend malor, me një lartësi të konsiderueshme... Ka 1.500 banorë... 4 faltore... 3 shkolla... 20 dyqane... 1 han dhe 3 mullinj. Pazari bëhet një herë në javë, çdo të martë. Aty zhvillohet një tregti mjaft e gjallë. Popullsia është shqiptare.

Frashëri ka një klimë të shëndetshme. Stinën e verës e ka të freskët, por dimrin mjaft të rreptë. Shumë herë rruga mbyllet me muaj të tërë nga bora e madhe...

(Me Tanzimatin — 1839) shumica e banorëve u detyrua të braktisë vendin e vet, Frashërin, dhe të mërgojë në Korçë, Manastir Janinë, Stamboll dhe gjetkë. Për këtë arsye Frashëri ka marrë rrugën e dekadencës.

Krahina e Frashërit quhet „Dagëlli” (Dağlı), që do të thotë „Malësi”. Tokën prodhuese e ka shumë të pakët. Përfshin 28 fshatra. Popullsia e kësaj krahine njihet për trimëri, guxim dhe zgjuarësi. Tani shumica e saj ndodhet në kurbet..., shkruan Sami Frashëri (1896).

² Kristo Frashëri, *Tre vëllezër pishtarë*, „Nëntori”, Tiranë, 1978, 11.

dhe vepruan në kushte shumë të vështira politike, ekonomike dhe sociale. Me një fjalë të tre vëllezërit Frashëri vdiqën duke punuar e duke luftuar, pra, vdiqën duke i lënë pas vedit gjurmët e veta në të gjitha poret e jetës shqiptare, veprat e të cilëve mbetën, të pavdekshme për herë e për jetë.

Vëllezërit Frashëri kishin edhe veçoritë e veta. Abdyl dallohej si politikan, Naimi si letrar, kurse Samiu si shkencëtar — historian, gjeograf, linguist, publicist etj. Shkurt ishte enciklopedist.

Abdyl Frashëri kishte një kulturë shumë të gjerë. Pas shkolimit në Janinë kishte shkuar në Stamboll ku kishte kryer liceun e Stambollit. Mandej kishte shkuar në Paris për t'i studiuar shkencat juridike. Pas kthimit nga Parisi Abdyl ishte emëruar profesor në Stamboll. Pak më vonë ishte emëruar myfti, por së shpejti kishte dhënë dorëheqje dhe ishte kthyer në Janinë. Në Janinë, Abdyl në mes të bashkatdhetarëve të vet, kishte bërë propagandë për fitimin e pavarësisë së Shqipërisë. Në Shqipërinë e Jugut i kishte përfituar të gjithë shqiptarët në zë për idenë e tij. Në Shqipërinë e Jugut Abdyl konsiderohej, në të vërtetë edhe ishte shqiptari më i arsimuar dhe diplomat më i shquar. Flitej se i dinte shtatë gjuhë të huaja. Kjo me gjasë nuk i shkonte, për shtat Portës së Lartë. Kështu, Porta e Lartë e thërret Abdylin në Stamboll dhe i beson një pozitë të lartë në administratën osmane. Kur Adbylhamdi II kishte ardhur në fron (1876) Abdyl Frashëri ishte caktuar për oficer të lartë në Pallatin e Sulltanit. Mirëpo, së shpejti Abdyl kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë e lartë dhe kishte shkuar në mesin e shqiptarëve në Stamboll.³

Veprimtaria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, pra, është ngushtë e lidhur me personalitetin e Abdyl Frashërit, i cili që, pamëdyshje, arterja aortë e Lidhjes, në krye të së cilës gjendej personaliteti, — siç na bënë me dije konsulli anglez në Shkodër, Kirby Green, me autoritet më të madh në turmat popullore shqiptare, Haxhi Ymer Efendi Prizreni. Ndërkaq, Abdyl Frashëri, siç thotë historiani osman Sülejman Külçe, — ishte udhëheqës më i shquar i Lidhjes Shqiptare, i cili kishte arsimim të mirë dhe që njohës i mirë i politikës së kohës.⁴ Shkurt, Abdyl ishte dora e djathtë e Ymer Efendiut nga Prizreni.

Duke pasur parasysh, pra, në radhë të parë dokumentet osmane dhe angleze konkludojmë se Abdyl Frashëri ishte njeri modest, largpamës, përparimtar, me energji të pashtershme, me frymë revolucionare, prijës i palodhshëm dhe gojëtar pashoq. Sipas dëshmisë së konsullit anglez në Prizren, St. John, Abdyl me fjalimin e tij të zjarhtë të mbajtur në Kuvendin e Përgjithshëm

³ Jov Hadži — Vasiljević, *Arbanaska liga — Arnautska Kongra* — Beograd, 1909, 32; N. Marenin, *'Albania i Albancit'*, Sofia, 1902, 62.

⁴ Süleyman Külçe, *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk*, Izmir, 1944, 250.

të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ua ngriti peshë zemrat të gjithë shqiptarëve.

Largpamësia, oratoria dhe revolucionariteti i Abdyl Frashërit pasqyrohet, në mënyrë të veçantë, që nga viti 1877 e 1878. Kur u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit në krye me Haxhi Ymer Efendi Prizrenin, Abdyl Frashëri ishte një nga anëtarët kryesor të Komitetit Qendror të Lidhjes (1877), komitet ky i cili u quajt Komitet Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare.⁵

Abdyl Frashëri në nëntor të vitit 1877 zgjedhet për deputet të Asamblesë së II Osmane. Lidhur me këtë zgjedhje jep një raport të hollësishëm zëvendës konsulli i Francës në Janinë, Moró. Në këtë raport jepen karakteristikat e deputetëve të Vilajetit të Janinës, respektivisht jepen karakteristikat edhe të Abdyl Frashërit, i cili kishte fituar 24 vota. Sipas këtyre zgjedhjeve Vilajeti i Janinës ishte përfaqësuar në Asamblenë e II Osmane nga Mustafa beu, Mehmet Ali beu (Vrioni) dhe Abdyl beu (Frashëri) midis muslimanëve, dhe nga Canaka, Daviço dhe Herito midis jomuslimanëve.⁶

Mustafa beu dhe Canaka efendiu kishin marrë pjesë edhe në Asamblenë e I Osmane (1876), kurse Mehmet Ali be Vrioni, Abdyl be Frashëri, Daviço efendiu dhe Harito efendiu ishin zgjedhur për herë të parë për deputet të Asamblesë së II Osmane.⁷

Sipas Morós, Mehmet Ali beu, që mori 39 vota, ishte nga familjet më të pasura çifligare shqiptare të Beratit,⁸ ishte nip i Ymer pashë Vrionit, i të famshmit rival e pasardhës i të famshmit Ali pashë Tepelenës (Janinës), në qeverinë e Epirit. Lumturisht i pajisur Mehmet Ali beu kishte marrë në Stamboll një edukim mjaft të kujdesshëm. Mehmet Ali Vrioni e fliste shqipen, osmanishten, greqishten dhe frëngjishten. Abdyl be Frashëri, ndërkaq, ishte prej një familjeje të mirë shqiptare të Janinës; ai kishte nam se e administronte mirë pasurinë e tij personale dhe, me të drejtë, njihej si njeri i aftë, me mend dhe me arsim; e fliste shqipen, osmanishten, greqishten dhe frëngjishten.⁹

Abdyl Frashëri në Parlamentin e II Osman ishte deputeti më aktiv. Ai, pothuajse, në çdo seancë të tij kishte diskutuar. Diskutimet e tij ishin të vrullshme, revolucionare dhe polemizuese.

⁵ Mbi Formimin e Lidhjes dhe të Fraksionit të Lidhjes shih gjerësisht monografinë time *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, të cilën është duke e botuar Enti Krahinor për botimin e teksteve dhe të mjeteve mësimore.

⁶ Ligor Mile, *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit* (Dokumente arkivash franceze), I, (1876-1879), Tiranë, 1978, 100,101.

⁷ *Po aty*, 101.

⁸ Mehmet Ali Vrioni ishte bashkëpunëtor shumë i ngushtë i Abdyl Frashërit, i cili mori pjesë edhe në delegacionin shqiptar në metropolet (kryeqendrat) e Fuqive të Mëdha të Evropës. Zatën, emri i Mehmet Ali Vrionit ceket në çdo dokument para emrit të Abdyl Frashërit. Kjo me siguri tregon se Mehmet Ali Vrioni ishte më i moshuar, njeri me influencë, i cili gëzonte edhe respektin e Abdylit.

⁹ Ligor Mile, *vep. e cit.*, 102.

Kishte polemizuar me deputetë, kishte polemizuar me Kryetarin e Asamblesë Osmane. Në bisht të lahutës e kishte vënë gjithë aparatit shtetëror të Perandorisë Osmane. Nëpërmjet të diskutimeve të tij, ai kishte vënë në pah mendimet e veta politike, filozofike, ekonomike, shoqërore, e arsimoro-kulturore. Ai kishte kërkuar me rrugën revolucionare dhe pa humbur kohë që të bëheshin ndryshime rrënjësore në strukturën shtetërore dhe shoqërore të Perandorisë Osmane, në dobi të popujve në përgjithësi, e në të mirë të popullit shqiptar, i cili ishte në gjendje më të mjerueshme, në veçanti. Këtë herë, do t'i zëmë në gojë vetëm katër diskutimet e Abdylit.¹⁰

Arsimi dhe kultura në tetëdhjetëvjetshin e shekullit XIX në Ferandorinë Osmane në përgjithësi, e në Shqipëri në veçanti, në krahasim me gjendjen e gjysmës së dytë të shekullit XV, ishte katastrofale. Prandaj, Abdyl Frashëri këtë çështje e ngrehu në Parlamentin e II Osman, më 14 janar 1878 (2 Ocak 1293). Abdyl Frashëri, në fjalimin e tij të shquar, në mes të tjerash, thotë: Në botë çdo begati dhe lulëzim që ka lidhje me qytetërimin, është arritur me anë të arsimit. Pa arsim asnjë popull nuk ka përparuar, por nga dita në ditë ka rënë; dhe në fund është ballafaquar me çdo farë fatkeqësie. Varësisht nga koha dhe gjendja te ne asgjë nuk është bërë në shkallë të duhur, dhe, me vite nxënësit jetën e shkatërrojnë në vende të kota. Përpos disa medreseve të zakonshme dhe të shkollës ushtarake, për popullin, çfarë shkollash kemi? Më parë u hap një fakultet i Universitetit.¹¹ Por, ende pa u hapur u mbyll. Më vonë u hap liceu i Galatasarajit, porse edhe këtij, fryti i denjë ende nuk iu pa. Kështu është në kryeqytet, në Stamboll. Po si është gjendja në viset e tjera të Perandorisë? Përveç në progjimnaze të disa qyteteve, ku mësimet zhvillohen pa plan e program, në qytete dhe në fshatra nuk ekzistojnë madje as progjimnazet e as shkollat fillore apo foshnjoret!¹²

¹⁰ Diskutimet e Abdyl Frashërit janë të regjistruara në procesverbalet e Asamblesë. Shih: Başbakanlık, Arşivi, İstanbul, *Meclis-i Meb'ûsân 1293=1878*, Zabit Ceridesi, 98, 100, 108, 113, 127, 128, 143, 144, 145, 146, 149, 166, 172, 193, 196, 207, 210, 220, 221, 222, 237, 240, 243; *Meclis-i Meb'ûsân 1293=1877*; 250, 257, 260, 263, 264, 331.

¹¹ Hoxha Tahsini (1812-1880) më 1880 e shtypi një abetare shqipe me germa arabe. Ky ishte një nga ideologët e zgjimit kombëtar të shqiptarët dhe për reforma. U lind në rrethinën e Janinës. Aty i ati shërbeu si kadi. Në vendlindje e kreu shkollën fillore e pastaj shkoi në Stamboll ku e kreu medresën. Më vonë në Paris studioi shkencat natyrore, sidomos matematikën dhe astronominë. Më 1868 kthehet në Stamboll dhe zgjedhet rektor i Universitetit (Darülfünun Müdürlüğü), i cili u hap në atë vit. D.m.th. hoxha Tahsini u bë rektori i parë i Universitetit të Stambollit. Si pasojë e intrigave të fanatikëve, në vitin e dytë të ekzistimit të tij, universiteti u mbyll. Pas kësaj Hoxha Tahsini jetoi me të ardhura të pakta, duke mbajtur mësimet vetëm në medresën e vet, në përpjetzën e Portës së Lartë (Babiâli). Në mes të dy fasadave të asaj godine gjendet, sot e kësaj dite, ora, si përmendore e Hoxha Tahsinin. Vdiq nga tuberkulozi në Ernikoj, ku edhe u varros. Veprat e tij janë: *Historia e krijimit ose natyrës* (Tarihi Takvim yahut Hilkat), *Bazat e astronomisë* (Esasi İlmî Heyet), *Psikologjia ose shkenca mbi shpirtin* (Psikoloji yahut İlmî Ruh), *Sekretet e atmosferës* (Esari Ab-ü-hava). (Shih: Skënder Rizaj, *Albanska abeceda u nauçno-j literaturi*, Jugoslovenski istorijski časopis, 1-2/1969, Beograd, 177).

¹² Başbakanlık Arşivi, İstanbul, *Meclis-i Meb'ûsân 1293-1878*, Zabit Ceridesi, Devre: 2, Cild: 2, İctima: 1, 144-145; Skënder Rizaj, *Abdyl Frashëri mbi arsimin dhe kulturen*, „Horizontet e Historisë”, No. 2, Prishtinë, 1978, 105-109.

„Ani që nuk e njoh Anadollin, — vazhdon pastaj Abdyl, — mendoj se dallimi nuk ekziston në mes të tij dhe të Rumelisë (Ballkanit) por mbi të gjitha në Shqipëri në asnjë fshat nuk ka shkollë. Mëshirë! Ne, me këtë injorancë si do të bëhemi të qytetëruar? Si do të përparojmë? Nga ky gjumë i rëndë kur do të zgjohemi? Mëshirë! Pastaj përpos dy shkollave për femra të hapura tani vonë në Stamboll, në provinca nuk ka asnjë shkollë për to. Femrat, ti përziejmë nga rendi i njerëzve apo të interesohemi për edukimin e tyre?! E dimë që: edukata e meshkujve është pjesë e edukimit të femrave. Në qoftë se nëna është injorante, e dini se në çfarë shkalle fëmija do të bëhet pa edukatë, pa moral dhe e prishur.¹³

Në fund të fjalimit të vet, Abdyl Frashëri, thotë: „Sa i ultë është arsimit ynë. Ai ka nevojë sa më parë të përhapet mirë edhe në vende të shpërndara. Tani, për ta mbrojtur e siguruar pasurinë dhe ardhmërinë e shtetit dhe të popullit, e në frymën e Kushtetutës, sa është e mundur më shpejt ta përhapim arsimin me vëmendje të përsosur. Metodrat e mësimi që përdoren në medrese dhe në mejtepe të anulohen plotësisht dhe të hapen shkollat e veçanta për femra dhe meshkuj:¹⁴ në fshatra, shkolla fillore dhe progjimnaze, në qendra të sanxhaqeve nga një gjimnaz, kurse në qendër të Perandorisë, në Stamboll, për të gjitha shkencat nga një fakultet të Universitetit. U mor vesh, ai mos të jetë sikurse universiteti i sotëm, por i kompletuar, ku do të ekzistojnë degët si: drejtësia, mjekësia, matematika, bujqësia dhe shkencat e tjera, d.m.th. të jetë një universitet sikurse në Evropë, universitet i kompletuar me sistem dhe subjekt të ri, duke mos lënë për vitin e ardhshëm, por, kjo çështje, në këtë vit të paraqitet për shqyrtim në Parlamentin tonë, dhe sipas nevojës të nxirret shpejt një ligj për t'i shërbyer përparimit të arsimit. Pastaj të formohet një akademi, d.m.th. të formohet shoqata e lartë e shkencave. Prandaj, kërkoj mëshirën e Kryesisë që ta aprovojë paraqitjen time.¹⁵

Ndërkaq, në fjalimin e tij të 24 janar 1878 (12 Ocak 1293), Abdyl Frashëri, duke polemizuar me deputet, thotë: „Do t'i jap përgjigje katër-pesë personaliteteve, të cilët u ngritën kundër fjalimit të Mehmet Ali be [Vrionit]. Ata thanë: „Injorancën [tonë] nuk e pranojmë, qytetërimi ynë është i përsosur'. Po, — thotë Abdyl, — jemi një popull që përparuam nga ndikimi i kulturës arabe. Mirëpo, pak a shumë u ndikuam edhe nga qytetërimi grek. Ndërkaq, evropianët kulturën e morën prej nesh, por ashtu e morën saqë në asgjë nuk na lanë! E, ne, e kemi lexuar historinë, prandaj dimë si ishte dhe në çfarë shkalle

¹³ Po aty.

¹⁴ Abdyl Frashëri ishte për zëvendësimin e mejtepeve dhe të medreseve me shkolla moderne, me program dhe plan bashkëkohor evropian.

¹⁵ Meclis-i Meb'ûsân 1293=1878, 145.

është kjo gjendje. Haxhi Ahmet efendiu¹⁶ tha: „në ditën që kaloi një personalitet¹⁷ këtej ai bëri fjalë për pasigurinë e mektebeve tona dhe për gjendjen e keqe të medreseve; këto pallavra nuk i pranoj'. Në të vërtetë, — vazhdon Abdyli, — personaliteti që foli dje¹⁸ për arsimin, sipas mendimit tim kishte të drejtë dhe përseris fjalimin tim të djeshëm, se tek ne nuk ekziston asnjë mektep (shkollë) në kuptimin e vërtetë të fjalës mektep (shkollë)".¹⁹

Siç theksuam edhe më parë Abdyl Frashëri ishte shumë aktiv në Parlamentin Osman. Me diskutimet e tij të ashpra, por konstruktive, i dha Asamblesë Osmane ton të veçantë, ton të gjallë, kahje çfarë duhej të kishte vetë ky institucion më i lartë i Perandorisë Osmane. Ai u rrok me deputetët konzervativ. Ai paraqitej në Parlament me plotkuptimin e fjalës si deputet popullor, si tribun (udhëheqës) popullor. Në këtë mënyrë në një diskutim të tij të 30 janar 1878 (18 Ocak 1293) thotë edhe këtë: Nëse kemi gazetë zyrtare, siç na bëri me dije Ohannes efendiu,²⁰ atëherë diskutimet tona le t'i boton çdo ditë; pasi që diskutimet tona po i marrin të gjitha gazetatat, madje po i botojnë edhe gazetatat e Evropës. Në rastë se është gazeta jonë zyrtare, ajo diskutimet tona, ndoshta, do t'i botojë pas një viti, sepse vëllimi i saj është i vogël, prandaj nuk do të arrij për t'i botuar. Megjithatë shpallja e diskutimeve tona, kështu të kalbura, të gjymta dhe të mbyllura, mendoj se nuk bëhen në asnjë vend. Gazeta zyrtare, zakonisht, i merr diskutimet, ato i boton menjëherë, e prej saj i marrin shkurtimin e tyre drejtpërsëdrejti gazetatat e tjera. Kështu veprohohet në gjithë botën".²¹

Pastaj në diskutimin e tij polemizues, Abdyl Frashëri, nënvizon: „Të kthehem nga ana tjetër. Thëniet e Rupen efendiut²² ishin: 'Duke folur le të na njohin aftësinë tonë, le të na zgjedhin përsëri në vitin e ardhshëm!' Përkundrazi, — nënvizon Abdyli, — personaliteti i cili e ka pranuar këtë post, postin e deputetit, nuk ka marrë ndonjë gradë dhe nuk më kujtohet që ndonjëherë të ketë thënë se 'nuk e di ndonjë çështje'. Kështu ka vepruar, ndoshta, për t'i shërbyer shtetit dhe popullit drejt dhe me besnikëri. Por fjalët e folura nga ai, Rupen efendiut, janë pallavra, janë fjalë boshe! Asambleja jonë nuk është asamble ekzekutive: Asambleja jonë flet pallavra. Asambleja ekzekutive është tjetër! Fjalët tona të folura nëse nuk zbatohen, së paku të shkruhen drejt. Gazetat osmane, qofshin ato që botohen në

¹⁶ Haxhi Ahmed efendiu ishte deputet i Ajdinit.

¹⁷ Është fjala për Mehmet Ali Vrionin.

¹⁸ Është fjala për Mehmet Ali Vrionin.

¹⁹ *Meclis-i Meb'ûsân 1293=1878*, 210.

²⁰ Ohannes efendiu ishte deputet i Stambollit.

²¹ *Miclis-i Meb'ûsân*, İkinci Cild, 13 Aralık 1877 — 16 Şubat 1878, 257.

²² Rupen efendiu ishte deputet i Jedrenës.

frengjishte, greqishte apo osmanishte, përpos „Basiretit”,²³ i cili që 5-6 dite filloi të shkruajë drejt, nuk i kushtojnë kujdes fare të shkruarit p.sh. duke shkruar: ushqimi u bë kështu, filani tha kështu, sot ra borë, që nuk kanë kurrfarë lidhje. Ato janë pa kuptim. Krejtësisht ndryshohen dhe cungohen. Kjo, Asamblenë tonë, jo vetëm që e turpëron, por edhe e ofendon. Këtë kurrë nuk do ta pranojmë.²⁴

Abdyl Frashëri, në fjalimin tjetër të tij, të të njëjtës ditë (30 janar 1878) i shfaq mendimet e veta mbi sistemin e administrimit të Perandorisë Osmane, respektivisht mbi nëpunësit e administratës osmane, në të cilët mbështetej fati i mbarë shoqërisë osmane të asaj kohe. Edhe me këtë diskutim Abdyli kishte për qëllim t'i zgjidhte çështjet themelore të cilat i brengosnin turmat popullore. Me këtë rast, Abdyli thotë: Zotërinj, para se t'ia filloj fjalimit tim ju lus që të më dëgjoni me vëmendje”. Pastaj, Abdyli, vazhdon: „Zotërinjtë e mij, në fjalimin tim modest, dorëzuar më parë, kam referuar se themeli i një shteti dhe i një populli, arsimit i plotë, ligji i drejtë si dhe administrimi i mirë i vendit varen nga nëpunësit e aftë, varen nga mbrojtja e vendit, varen nga arsimit. Ky është mendimi im i shprehur mbi nëpunësit e rregullt.”²⁵

„Sa është nevoja për një shtet dhe për arsim të një populli, — vazhdon Abdyl, — aq është nevoja për një ligj të drejtë, e në sajë të atij ligji mund të kenë sukses punët shtetërore dhe mund të sigurohet populli. Nuk mund të them se tek ne nuk ka ligj, por as nuk mund të them se çdo ligj i yni është i shkëlqyeshëm. Çdo ditë bërtasim se na mungon ligjshmëria. Përmirësimi nuk është i mundshëm, sepse nuk kemi njerëz ligjdhënës.”²⁶

Abdyl Frashëri, në këtë fjalim, rreth legjislaturës osmane thotë: Për t'i themeluar shkollat tona; për t'i krijuar legjislatorët në shkallë të shkencëtarëve të aftë; për t'i riorganizuar shkollat; për t'i stolitur ato me mjeshtër të atyre njerëzve; për konsolidimin disavjeçar të çdo sistemi të bindshëm dhe nëse për këtë nevojë do të bëjmë orvatje të mjaftueshme si dhe nëse me këtë rrugë do ta kërkojmë përparimin dhe përmirësimin, vallë sa vite do të na nevojiteshin? A do të na premtojë koha. Jemi mirënjohës që shteti ynë urdhëroi që kjo vështirësi dhe ngecje të përvetësohet, që për nevojat e njerëzve, sa për të provuar, e ka marrë ligjin e Evropës dhe me ndërmjetësimin e Këshillit Shtetëror (Şûrâ-yi Devlet) ai është përkthyer. Nëse legjislati i një shteti është despotik, nëse despotizmi dhe kushtetuta ia kanë përshatur sistemit kushtetues, atëherë kjo është lidhërim, sepse

²³ „Basiret” ishte një gazetë në të cilën shkruanin rilindasit shqiptarë: Abdyl, Samiu, etj.

²⁴ *Meclis-i Meb'ûsân*, İkinci Cild, 257.

²⁵ *Po aty*, 264.

²⁶ *Po aty*.

Këshilli Shtetëror duke mos i kushtuar vëmendje kësaj çështjeje me rastin e përkthimit të ligjit evropian shumicën e detyrimeve apo të paragrafeve i ka falsifikuar. Në këtë mënyrë, përsëri sistemi i administrimit i është përshtatur një sistemi tjetër dhe duke mos pasur kohë për të humbur minutin, Asambleja jonë, ndërkaq, në vend që të merret me punët e veta, merret padrejtësisht me punë të tjera. P.sh. në Projektligjin e vilajetit përsëri çdo punë lihet në duar të valiut; në Projektligjin e gjykatës civile të gjitha gjykimet lihen nën mbikëqyrjen e valiut; në Projektligjin e bashkisë (belediye) nuk u bënë ndryshime të mëdha nga ato të vjetrat. Beledijet tashmë nuk u liruan nga tiranizmi i valiut. Kështu, pra, ky është vendi i çudisë dhe i vëmendjes!²⁷

Prandaj, — nënvizon Abdyl Frashëri, — këtë kohë të shtrenjtë mos ta shpenzojmë për gjëra të kota, përkundrazi të heqim dorë prej tyre. Pra, të këshillohemi për përmirësimin e çdo pune të shtetit dhe të popullit si dhe për nevojën e legjislaturës së tërësishme; t'i përshtatemi Kushtetutës; t'i përshtatemi pikërisht drejtësisë. Me fjalë të tjera të shihet me sy eksperimenti i punëve të mira. Mandej, po qe se Legjislatura evropiane me rastin e përkthimit, në Këshillin Shtetëror do të bëhet përkthim i denjë dhe në kohën e lënë për ta përforcuar praktika, do të respektohet Ligji, vallë mbikëqyrja e shtetit dhe e popullit a nuk do të sjellë më lehtë dhe më shpejt fat dhe shpëtim? Gjithsesi po. Nëse është kështu mos ta humbim kohën. Kësaj çështjeje t'ia vejme pikën, ju lus.²⁸

Përkritazi me nëpunësit shtetërorë, — Abdyl Frashëri konstaton, — se ata, me përjashtim të disave, nuk ishin të aftë për vendet e tyre të punës. Pastaj thotë: Nuk mund të mohohet se këtyre nëpunësve u është besuar administrimi i vendit, sepse disa prej tyre janë ngritur nga rojtarët e anëtarëve të Qeverisë (vükelâ) dhe të vezirëve (vüzera') si dhe nga kujdestarët e kuajve, d.m.th. janë ngritur nga profesionet që nuk kanë lidhje me nëpunësi, ndërkaq, disave prej tyre u mungon shkrim-leximi. Për këtë arsye nuk ka nevojë të thuhet se si do ta kryejnë detyrën e vet".²⁹

Edhe ata që dinë shkrim-lexim e nuk e dinë qëllimin e vërtetë të shtetit dhe të popullit, — vëren Abdyl Frashëri, — nuk është e mundur që ta kuptojnë legjislaturën tjetër dhe të veprojnë drejtë në harmoni me të; sepse legjislatura nuk mund të zbatohet vetëm nga njeriu që din të lexojë dhe të kuptojë. Ligjet mund të kuptohen duke u studiuar gjatë ligjëratave në shkollë. Zaten, nëse kjo do të mund të kryhej me anë të leximit, atëherë këtë punë mund ta kryejnë të gjithë mësuesit e fshatrave që dinë të lexojnë arabisht e nuk do të kishte pasur nevojë që 5-10 vjet

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

të studiohen shkencat juridike në shkolla dhe në medrese. Për gjetjen e një shtegdaljeje nga kjo situatë fola dje kur bëra fjalë për çështjen e arsimit dhe me ç'rast vura në pah se nëpunësve të aftësuar në shkolla speciale, të cilët janë duke shërbyer sot e kësaj dite, së bashku me të gjithë nëpunësit, për të mbetur në pozitë duhet t'i takojnë tarafit (partisë), madje duke mos e gjetur rrugën e vet. Pastaj, nga mungesa e arsimit tonë studimi i shkencave në gjuhë të huaja ka mbetur në harresë plotësisht. Personalitetet e tjera, ndërkaq, duhet të emërohen pasi që ta japin provimin e aftësisë dhe ta dokumentojnë profesionin e tyre me diplomë. Prandaj për emërime në pozita, tashmë, gjithsesi është i domosdoshëm dhe shumë me rëndësi që të formohet një komision i përbërë nga dijetarët, nga juristët dhe nga personalitetet përkatëse.³⁰

Nga ana tjetër, — thekson Abdyli, — nëpërmjet të funksioneve nëpunësish, do të kryhet një kurs, e me nëpunësi, sipas rëndësisë së pozitës në administratë, nuk do të mbeten të paaftët. Nëpunësve, për këtë qëllim, t'u caktohet rroga e mjaftueshme, e me rastin e konstatimit të kryerjes mirë të shërbimit t'u jepet shpërblimi. Përkundrazi në të ardhmen, nëse vlerësohet se nuk i plotësojë kushtet e nëpunësve, të pushohen nga puna. Por, nëse nga vështirësia, dënimi nuk do të kryhet do të qëndrojnë në pozitë përsëri. Ndërkaq, kurrë nuk dyshoj në sjelljet e mira të nëpunësve tanë, të cilët janë me pikëpamje në harmoni me sistemin e Ligjit. Vetëm se anëtari i Komisionit të përmendur, sipas mendimit tim modest, është pak vështirë të jetë i drejtë dhe i sinqertë, sepse tek ne është e ditur, se çdo gjë bëhet me mbrojtje, respektivisht me krah, d.m.th. me proteksion. Po që se jonjeriu, respektivisht njeriu i lig, do t'ia sjellë Komisionit një dokument nga vendi i lartë (nga pushteti i lartë), atij do t'i jepet diploma e shkallës së parë dhe nuk mund t'i mohohet kurrsesi emërimi në nëpunësinë e dëshiruar. E për ta zgjidhur këtë çështje ia tërheq vërejtjen deputetëve të njerëzishëm. Për këtë arsye, mendoj se nuk ka shtegdalje tjetër, pos asaj që në këtë Komision të futen disa personalitete nga shtetet e huaja, me kusht që ta dijnë gjuhën tonë, të jenë të drejtë dhe të sinqertë.³¹

Kështu, pra, shteti dhe populli ynë, — në fund të fjalimit të vet konstaton Abdyli, — menjëherë, dhe në çdo pikëpamje do të përparojë. Për t'u qytetëruar nevojiten vetëm tri kushte, d.m.th. arsimi, ligjshmëria dhe kujdesi i veçantë për nëpunësit. Vendi do të përparojë me shpejtësi dhe pa kaluar dhjetë vjet nuk do të dallohet nga Evropa. Në këtë mënyrë, pra, do ta shohim përparimin me tërë fuqinë, shpresat do të sendërtohen me shpejtësi,

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty, 265.

mendimet e deputetëve të njerëzishëm si dhe pritjet e patriotëve do të realizohen pikërisht.³²

Abdyl Frashëri si deputet i Parlamentit Osman, në janar të vitit 1878, për muhaxhirët dha një ndihmë mjaft të madhe. Ajo kapte shumën prej 1.250 groshë, respektivisht 12,50 lira dukatë.³³

Sipas kujtimeve të Gani Frashërit, në vitin financiar (maliye) 1292/93 (1876/1877) në Janinë ishte mbajtur mend kryengritja e Bosnjës. Bisedohej për copëtimin e Perandorisë Osmane. Sami Frashëri shkruante në atë kohë, artikuj frengjisht në të përkohshmen vieneze *Correspondence Politique*. Abdyl Frashëri, ndërkaq, takohej tinëz me ca miq të tij, si me Myslim beun, Daut beun, Ragip beun, Ibrahim be Dragotin, Mane Tahirin, Myslim Vasjarin etj. Nga Stambolli atëherë vjen në Prevezë dhe në Janinë Abedin be Dino, me cilësi të Kryetarit të Komisionit të Jashtëzakonshëm, në të cilin komision ishin: Abdyl Frashëri, Ferid Vlora, Mehmet Ali Vrioni, Neki Lohohova, Sabri Gjirokastra dhe si duket edhe: Myslim beu me shokët që u përmendën. Kryesekretar i Komisionit ishte Sami Frashëri ndërsa (zëvendëssekretar) Sami efendi Preveza. Në kohën kur punonte ky komision ngjau puna e Lëkurës³⁴ Komisioni hartoi një *mazbatë* (vendim i një kuvendi), në të cilin parashihej: Njësimi i të katër vilajeteve në një të vetëm. Ky ishte kurdoherë mendimi dhe dëshira e Abdyl Frashërit. Më vonë, Ferid pashë Vlora, kur bëhet sadriazem (vezir i madh = kryeministër)³⁵ e gjen, në një torbë, *mazbatën* bashkë me shkresat e tjera në Pallat të sulltan Abdyl Hamidit II. Bisedimet bëheshin kurdoherë jashtë, në shtëpitë e miqve.³⁶

Nga kjo pjesë e kujtimeve të Gani Frashërit, anëtar i Lidhjes Shqiptare, bashkëkohës i ngjarjeve politike që u zhvilluan në Shqipëri në mes të viteve 1876—1881, marrim vesh se pas kryengritjes së Bosnjës (1876—1877), filluan aksionet e komitëve grekë në Nartë e Tesali, d.m.th. në Shqipërinë Jugore. Filloi pastaj pëshpëritja rreth copëtimin të Perandorisë Osmane. Po ashtu, në pranverë të vitit 1877, Rusia i shpalli luftë Perandorisë Osmane, me ç'rast hyn në luftë, edhe Serbia, Mali i Zi, Bullgaria në anën e Rosisë. Ushtritë e vendeve të përmendura, gjatë vitit 1877, përparuan me sukses në drejtim të Shqipërisë Veriore dhe të Mesme. Të gjitha këto dukuri i shqetësuan shqiptarët seriozisht. Elita e shqiptarëve ndodhej në Stamboll, qoftë si deputet të Parlamentit Osman, qoftë si punëtor shkencor, kulturor, shoqëror,

³² Po aty.

³³ *Meclis-i Meb'ûsân 1293=1878*, 154.

³⁴ Bandat greke në shkurt të vitit 1878 e sulmuan Lëkurën, pranë Sarandës.

³⁵ Mehmet Ferid pashë, Ferid pasha (Vlora) u zgjodh në postin e sadriazemit pesë herë: I. 15 janar 1903 — 22 korrik 1908; II. 19 maj — 21 korrik 1919; III. 21 korrik — 1 shtator 1919; IV. 5 prill — 31 tetor 1920; V. 31 korrik — 17 tetor 1920, dorëheqje.

³⁶ Petraçq Pero, *Kujtime nga Lëvizja për Çlirimin kombëtar (1878-1912)*, USHT, TH, Tiranë, 1962, 83.

etj. Këta, kur u mbajtë Konferenca e Fuqive të Mëdha (26 dhjetor 1876 —20 janar 1877), në Stamboll, më së miri i panë pazarllëqet që zhvilloheshin rreth tokave me popullatë shqiptare. Prandaj, mu në Stamboll, sipas të gjitha gjasave, kjo elitë shqiptare u mor vesh për t'u organizuar politikisht dhe ushtarakisht në mënyrë që t'i dalë ballë rreziqeve që u kanoseshin. Kështu, organizojnë Lidhjen Shqiptare si organizatë politiko-ushtarake, me Komitetin Qendror në krye. Anëtarët e Komitetit Qendror dhe të Komitetit të Stambollit shkojnë më vonë në terrene ku organizojnë komitetet krahinore dhe komitete lokale. „Komisioni i Jashtëzakonshëm”, siç quhet nga Gani Frashëri, nuk ishte gjë tjetër, pos një nga komitetet e Lidhjes Shqiptare, në këtë rast është fjala për Komitetin e Stambollit, si degë e veçantë e Komitetit Qendror. Këto „komitete lokale”, apo të deleguarit e „Komitetit Qendror”, apo të „Komitetit të Stambollit” i mbanin mbledhjet „tinëzish” (ilegalisht) dhe në vende të ndryshme. Në ato mbledhje diskutonin për çështjet e mbrojtjes së tërësisë territoriale të vendit. Këto komitete shkruanin memorandume, peticione, ankesa, të cilat ua drejtonin Sulltanit dhe Fuqive të Mëdha, me të cilat protestonin kundër copëtimit të tokave, dhe aneksimit të tyre shteteve fqinje, si dhe kërkonin që krahinat me popullsi shqiptare të bashkohen në një vilajet, si e vetmja alternativë e mbrojtjes së tërësisë territoriale. Qeverisjen dhe mbrojtjen e vendit, pra, e morën shqiptarët në duart e veta, nëpërmjet të „komiteteve” apo „komisioneve të jashtëzakonshme” të Lidhjes. „Komitetet”, „komisionet”, „shoqatat” (societies), apo „kruzhonet” (kružoci), të formuara në Shqipëri apo jashtë saj, ishin organizata kombëtare (the national societies) të Lidhjes Shqiptare (the Albanian League), organe këto që e mbanin emrin e shquar „Lidhja Shqiptare”.³⁷

Lidhur me natyrën e Paqes së Shën-Stefanit Abdyl Frashëri thotë: „Rusia që ka deklaruar se luftën po e bënë për çlirimin popullatave të lindjes, ka përfunduar Traktatin e Shën-Stefanit që është kundër këtij programi dhe, jam i sigurt, kundër qëllimeve të Evropës. Jemi duke iu drejtuar Evropës, me shpresë se ajo do t'i ndreqë gabimet që po bëhen ndaj Shqipërisë. Është e vërtetë që si pasojë të këtij traktati, Evropa nuk humbet veçse humb ndikimin dhe interesat e saj; edhe vetë Perandoria Osmane nuk humbet, veçse një pjesë të të ardhurave të saj dhe të fuqisë së saj. Ata që humbasin në këtë luftë janë popujt e Lindjes, ata popuj, për çlirimin e të cilëve Rusia pretendonte të bënte luftën; ndërsa grekët, shqiptarët, rumunët dhe, ndoshta edhe vetë bullgarët, serbët dhe boshnjakët, janë ata të cilët tash për tash

³⁷ Constantine A. Chekrezhi, A. B. (Harv.), *Albania Past and Present*. New York, 1919, 57; N. Marine', *Albania i Albancit' Sofia*, 1902, 63 (Tuk' e m'stoto da spomenem', če v'Atina i Bukurešč' se obrazovaha v' posl'ānit' godini malki političeski albanski kružoci, koito nosjat' gr'movnoto ime „Albanska Liga”).

duket sikur janë të dashurit e pushtuesit modern, por që shpejt ose vonë, do të bien në një skllavëri që do t'i bëjë të qajnë të kaluarën e tyre...".³⁸

Abdyl Frashëri kishte filluar një fushatë kundër aspiratave greke ndaj Epirit, pak kohë para Samiut, gjë për të cilën ishte bërë objekt i sulmeve greke, sidomos të gazetës „Neologos”. Gazeta e Stambollit „Basiret” më 9 mars 1878 boton një letër të hapët të Abdylit, të nënshkruar „Yanya mebusu Abdul” (Deputeti i Janinës Abdyl). Në këtë artikull analizohet situata pas marrëveshjes së Shën-Stefanit, e sidomos gjendja e shqiptarëve, një pjesë e të cilëve iu ishte premtuar grekëve. Në letër ai flet gjërësisht mbi shqiptarët, përhapjet e tyre gjeografike, historinë e tyre, vetitë morale, problemet e kufijve me fqinjët, sidomos me grekët. Pra, të shohim, se si i shkroi këto penda e Abdylit:

„Lidhur me qëllimet agresive të Greqisë ndaj Shqipërisë, respektivisht ndaj Epirit, duhet theksuar faktin e mirënjohur se Epiri është pjesa jugore e Toskërisë, i përbërë nga sanxhaqet e Janinës, të Prevezës, të Gjirokastrës dhe të Beratit, të banuara nga trimat çamë dhe labë, ku, përveç kazasë së Nardës në Sanxhakun e Prevezës dhe kazasë së Krajnës në Sanxhakun e Janinës — e tërë popullsia është shqiptare dhe askush nuk flet greqisht. Prandaj, Greqia nuk ka kurrfarë të drejte apo kompetence të kërkojë këto vende”, Abdyli kërkon nga Qeveria Osmane që në asnjë mënyrë të mos pranojë që vendet shqiptare t'u dorëzohen fqinjëve. E, nëse Qeveria do të ishte e shtërnguar t'i lëshojë këto vende, është e sigurt se „shqiptarët do të rezistojnë deri në frymën e fundit, ata nuk do të lejojnë të shkelet atdheu i tyre, vëllezërit e tyre nuk do t'i braktisin në duart e huaja... Prandaj, unë ua bëjë me dije kompetentëve të shtetit dhe të botës politike në emër të gjithë popullit shqiptar dhe në emër të njerëzisë dhe të qytetërimit që të mos pranojë që ky popull besnik të zhduket dhe të shuhet”.³⁹

Ky alarm i Abdyl Frashërit e kishte prekur „Neologisin”, i cili së shpejti i vërsulet me një varg fyerjesh. Në numrin 62, dt. 29 mars 1878, botohet përgjigjja e Abdylit, ku, midis të tjerash, thuhet: „Në përgjigjen e përmendur nuk flitet për çështjen në fjalë, por ajo është mbushur me ndytësira, gjëra pa kurrfarë kuptimi, në kundërshtim me çdo moral, edukatë dhe ligj, ajo provon se autori është grek vagabond e rrugaç. Prandaj, t'u përgjigjem rezilëve të këtillë, as që ka hije as që më lejon ndera. Vetëm në lidhje me çështjen kryesore se Epiri, d.m.th. Shqipëria e Jugut është qysh nga kohën më të lashta tokë shqiptare — nëse

³⁸ Kristo Frashëri, *Tre vëllezër pishtarë*, Tiranë, 1978, 21.

³⁹ H. Kaleshi, *Burimet lidhur me studimin e Sami Frashërit*, Buletini i Punimeve Shkencore të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, VIII, Bleni A, Prishtinë, 1971, 45.

ndodhet ndokush që mund t'i kundërshtojë thëniet e mia brenda caqeve të ligjit, moralit e edukatës, duke i mposhtur të vërtetat e mia me prova të fuqishme — unë do t'i jem mirënjohës".⁴⁰

Mendimi politik i Abdyl Frashërit shihet edhe nga një artikull i tij me titull „Letër nga Janina” botuar në gazetën e Stambollit „Basiret”, më 21 prill 1878, ku thuhet: „Shqiptarët, të cilët në natyrën e tyre janë të lidhur me virtytin e burrërisë dhe të trimërisë, nuk i janë nënshtruar asnjë kombi qysh prej kohëve më të vjetra, edhe pse ata vetë nuk kanë qenë kurrë pushtues. Në luftë për të mbrojtur lirinë e tyre dhe për të zbrapsur sulmet e armiqve, ata kanë treguar sa e sa vepra për të qenë shembuj në sytë e pasardhësve të tyre. Në një kohë kur osmanët jepen pas pushtimeve, kur forca dhe pushteti i tyre habiste botën dhe kur fuqitë e mëdha si Bizanti, Serbia, Hungaria, Polonia dhe Gjermania (Austria — S. R.) nuk ishin të zonjat t'u bënin atyre ballë... shqiptarët u qëndruan sulltanëve të mëdhenj osmanë, si sulltan Muratit, sulltan Bajazidit dhe sulltan Mehmedit II...”.⁴¹

Qysh nga gjysma e dytë e majit, — konstaton Jov. Hadži-Vasiljević, — fillon të tubohet në Prizren parësia shqiptare nga e gjithë Shqipëria. Brenda tri-katër ditësh arrijnë afro 300 burra. Ata ishin përfaqësues të fiseve dhe të bajraqeve nga të gjitha viset dhe krahinat ku jetonin shqiptarët. Shqiptarë të krishterë (katolikë dhe ortodoksë) kishte pak. Ata punonin në Stamboll për pavarësinë e Shqipërisë. Këta përfaqësues ishin njerëz të qetë — shtëpijakë — dhe kurrfarë të keqe nuk u kanë bërë serbëve.⁴²

Në rast se, pra, konkludimi i sipërpërmendur është i mbështetur në fakte historike, të cilët autori nuk i thekson, por, për saktësinë e të cilëve nuk mund të dyshojmë, në atë rast, kuptojmë se në gjysmën e dytë të majit, qenka mbajtur një tubim i madh i shqiptarëve, një kuvend madhështor burrash, por, këtë kuvend nuk duhet ta konsiderojmë si Kuvend të Përgjithshëm të Lidhjes. Për te do bëjmë fjalë më vonë.

Në Prizren, shqiptarët nga viset veriore, tanimë, e kishin formuar këshillin e ngushtë, i cili kishte për detyrë t'i presë deputetët popullor dhe të interesohet për ta. Organet osmane — mytesarifit — nuk merr kurrfarë masash kundër këtij tubimi dhe kuvendimi të shqiptarëve. Nga Stambolli, kundër vullnetit të Portës, vijnë Abdyl Frashëri dhe Jani Vreto. Këta, nga Stambolli, sjellin Programin, të cilin, më vonë, në mbledhjet e Kuvendit e shqyrtojnë dhe e miratojnë. Sipas këtij Programi Shqipëria duhet të organizohet në katër pashallëqe: I. *Janina*; II. *Shkodra* me Tiranë e Elbasan; III. *Shkupi* me Dibër, Tetovë, Gostivar, Prilep,

⁴⁰ *Po aty*, 46.

⁴¹ Kristo Frashëri, *vep. e cit.*, 24.

⁴² Jov. Hadži-Vasiljević, *vep. e cit.*, 39.

Veles, Manastir dhe Ohër; IV. *Peja* me Gjakovë, Prizren, Jeni Pazar, Mitrovicë, Sjenicë, Prishtinë, Gjilan, Preshevë e Kumanovë.⁴³

Këto të dhëna, të cilat na i prezenton Jov, Hadži-Vasiljević, vërtet, janë me interes. Sa i përket Programit të organizimit të Shqipërisë, atë duhet kuptuar në këtë mënyrë: Lidhja, sipas Programit të theksuar, parashihte, të krijojë një Shqipëri të njësuar, si një vilajet, i cili, administrativisht, duhej të ishte i ndarë në njësi administrative më të vogla, në katër sanxhaqe, apo mytesarrifllëqe (krahina), e këto në kaza (rrethe) përkatëse. Por, një Shqipëri e tillë duhej të ishte autonomi, e qeverisur nga shqiptarët dhe në gjuhën shqipe.

Sipas Jov, Hadži-Vasiljević, shqiptarët kuvendimin e parë të tyre e mbajnë më 23 maj. Kuvendimet i mbanin në xhaminë e shquar të Prizrenit, në Bajrakli Xhami, meqë myderrizi i saj, haxhi Ymer Prizreni, ishte kryetar i përkohshëm i Kuvendit të Prizrenit. Mbledhjet e Kuvendit ishin sekrete. Pos përfaqësuesve dhe të ftuarëve të grishur nga Prizreni dhe rrethina, askush tjetër nuk ka mundur të marrë pjesë në mbledhje. Mbledhjet zgjatën dy javë të plota, dhe mbaheshin për çdo ditë. Në fund u formua *Këshilli Kryesor i Kuvendit*. U formua edhe lista e komisarëve, të cilët kishin për detyrë që të krijonin nënkëshilla nëpër gjithë Shqipërinë, me qëllim që t'i përhapnin idetë e Kuvendit. Këta komisarë, gazetatat serbe i quanin, u mor vesh me ironi, „barojat fluturuese shqiptare”.⁴⁴

Në *Këshillin Kryesor të Kuvendit* kishin hyrë: haxhi Ymer Efendiu, myderriz nga Prizreni, Ali pashë Gucia, Sylejman agë Vokshi, Abdyl (Avla) pasha nga Peja, molla Zeka nga Peja, Zejnel efendiu nga Peja, Shaqir agë Peja.⁴⁵ Ahmet Korenica nga Gjakova, Hasan pasha Derala dhe Rexhep pasha, të dytë nga Tetova, Iljaz pasha nga Dibra, Ejup beu nga Jani Pazari, Ali Draga nga Mitrovica, Osmani, myfti nga Prishtina, Ali Kurteshi nga Mitrovica, Fil Mustafa beu nga Shkupi, Mustafa Koxhabashi nga Shkupi, Jashar beu nga Kumanova, haxhi Ismail efendiu, myderriz nga Kumanova, Maksut efendi Shehu nga Presheva, Kamber aga dhe haxhi Abasi nga Presheva, Ali beu nga Tirana, Arsllan beu nga Elbasani, Abdyl efendiu nga Shkupi, haxhi Sasiku nga Tetova, Hysejn beu nga Gjilani, Binak Aliu, Ali Ibra (nga Malësia e Gjakovës — S. R.), N'tali beu nga Prelesteja, Ymer beu dhe Qazim beu nga Gjirokastra, Naim beu (i vëllai i Abdyl Frashërit) nga Frashëri, N'tali beu nga Preveza, Abedin pasha (axha i Abedinit, ministër i Punëve të Jashtme i Perandorisë Osmane),

⁴³ *Po aty*, 39, 40.

⁴⁴ *Po aty*, 40. „Leteci korovi arnautski” = „Barojat fluturuese shqiptare”.

⁴⁵ Te Jov. Hadži-Vasiljević figuron se Shaqir aga ishte nga Peja, i ati i Bajram Currit. Mirëpo, më sa dimë, Currët ishin nga Gjakova. Por, ndoshta në atë kohë Shaqir aga jetonte në Pejë.

Mustafa pasha nga Vlora, Pjetër beu nga Janina, Jani Vreto nga Kanina dhe 17 vetë nga parësia e Shqipërisë së Mesme dhe Jugore, në mes të cilëve, më i dalluari ishte Abdyl beu nga Frashëri.⁴⁶

Këshillin Kryesor të Kuvendit nuk guxojmë ta identifikojmë me *Komitetin Qendror*, sepse *Këshilli* ishte organ shtetëror i Lidhjes, i cili, me këto hapa, ishte duke e konstituuar *Asamblenë Kushtetuese Shqiptare, Asamblenë Konstituive Shqiptare*, e cila njihet me emrin *Kuvend i Përgjithshëm i Lidhjes*. Ndërkaq, *Komiteti Qendror* ishte organ i Lidhjes si organizatë politike. Kuptohet, vetvetiu, se shumica e anëtarëve të *Komitetit Qendror* kanë qenë edhe anëtarë të *Këshillit Kryesor të Kuvendit*. Me këtë rast haxhi Ymeri ishte edhe kryetar i *Komitetit Qendror* edhe, u mor vesh plotësisht si gjë normale, kryetar i përkohshëm i *Këshillit Kryesor të Kuvendit*, i cili duhej ta ftonte dhe ta organizonte *Asamblenë Kushtetuese*, që do t'ia fillonte punës më 17 qershor 1878.

Të gjithë pjesëmarrësit e kuvendeve, pra, nuk ishin anëtarë të Lidhjes Shqiptare, si organizatë politike e ideologjike. Anëtarët e Lidhjes si organizatë ishin më të pakët, ishin më të zgjedhurit, më të besueshmit, pra, ata që e kishin pranuar Statutin e Lidhjes. Kurse, të tjerët, d.m.th. shumica, ishin partizanë, ithtarë të Lidhjes. Anëtarët e Lidhjes si organizatë politike, ishin kryesisht ilegal, ishin frymëzues, organizatorë dhe prijtarë të lëvizjes popullore, të lëvizjes partizane, respektivisht të luftës nacionalçlirimtare, me një fjalë, ishin luftëtarë të denjë të Lidhjes Shqiptare

Posa u konstitua *Këshilli Kryesor i Kuvendit* menjëherë thirrret *Kuvendi Publik i Shqiptarëve* të Prizrenit dhe të rrethinës. Tubimi i parë u bë më 5 qershor 1878, ku morën pjesë shumë shqiptarë. Sipas një versioni marrin pjesë 5.000, ndërsa sipas një versioni tjetër 15.000—20.000, kurse sipas raporteve ushtarake serbe në këtë miting ishin të pranishëm 30.000—40.000 burra shqiptarë. Në këtë tubim të madh Lidhja i paraqiti vendimet e veta kryesore, të cilat ishin: 1) Shqiptarët kanë vendosur që mos t'ia japin kurrsesi tokat e veta Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, ose ndonjë shteti apo populli tjetër; 2) që të merren të gjitha tokat e pushtuara nga Serbia dhe Mali i Zi gjatë luftërave të fundit, ku kanë jetuar shqiptarët; 3) që Lidhja përkitazi me këto çështje të punojë në Evropë, në Kongresin e Berlinit dhe në Oborret mbretërore; 4) që Lidhja të punojë, me të gjitha fuqitë e veta, për t'iu kthyer shqiptarëve vetëqeverisja e cila iu kishte marrë para pesëdhjetë e më shumë vjetësh, respektivisht që mos të dërgoheshin më nëpunësit nga Stambolli dhe ata mos t'i emë-

⁴⁶ Jov. Hadži-Vasiljević, *rep. e cit.*, 40, 41.

rojë më Sulltani dhe Porta, por vetë shqiptarët t'i zgjedhin nga mesi i tyre; 5) që Sulltani mos të kërkojë më prej shqiptarëve rekrutë dhe tatime.⁴⁷

Nga këto kërkesa të Lidhjes Shqiptare, siç po shohim, dallohen dy probleme urgjente të preokupimit të saj. Problemi i ruajtjes së integritetit tokësor të Shqipërisë dhe vetëqeverisja, d.m.th. krijimi i administratës autonome shqiptare.

Vendimi i Lidhjes, vendim ky i miratuar nga tubimi, shkruhet në formë të një *muazereje*⁴⁸ në dy ekzemplarë. Në të dy ekzemplarët janë vu mbi 4.000 nënshkrime dhe *myhyre* (vula). Njëri prej tyre menjëherë i dërgohet Sulltanit, kurse tjetri i dedikohet Kongresit të Berlinit. Pastaj zgjedhen dy përfaqësues: Abdyl Frashëri dhe Jani Vreto me detyrë që t'ia dorëzojnë *muazeren* Kongresit të Berlinit, Shtypi i huaj (*Presse, Correspondence Politique*, i Vjenës, etj.) shënon vizitën e Abdyl Frashërit dhe të Jani Vretos që ia bënë Bizmarkut, Bikonsfildit, Krispit dhe qeveritarëve të tjerë të Evropës pa dhënë shënime të tjera. Prej tyre kishin kërkuar mbrojtjen e çështjes shqiptare.⁴⁹

Derisa puna e Tubimit ishte punë publike, puna e *Këshillit Kryesor të Kuvendit*, ndërkaq, mbahej fshehtë nga Sulltani dhe organet e tjera të pushtetit osman.⁵⁰

Pra, Lidhja Shqiptare e haxhi Ymer Prizrenit ishte fuqizuar shumë, kishte marrë një rrugë revolucionare, rruga e së cilës paraqiste rrezik edhe për sundimin e vet Sulltanit-halife. Pastaj, meqë ishte ftuar Kongresi i Berlinit nga Fuqitë e Mëdha, me qëllim që t'i rishikojë vendimet e Marrëveshjes së Paqes së Shën-Stefanit, Sulltani nuk kishte më nevojë aq të madhe për Lidhjen Shqiptare, në mbrojtjen e tërësisë territoriale të Perandoris Osmane. Për këtë shkak vendosi që të thejë tehun revolucionar të Lidhjes. Në këtë mënyrë Sulltani dyfytirësh i ftoi në Pallatin e tij disa nga paria shqiptare si: sheh Mustafën nga Tetova, Abdyl Frashërin etj. Derisa sheh Mustafa pranoi të shkojë të Sulltani, Abdyl Frashëri, nuk pranoi. Sulltani u shkroi edhe udhëheqësve të tjerë të dalluar të Lidhjes Shqiptare, myderrizit të Prizrenit, Haxhi Ymer Efendiut, kadiut të Gjakovës, Ahmet efendi Korenicës, myftiut të Dibrës Jonuz Zuhdi efendiut, me qëllim që të vepronin sipas urdhërit të tij të lartë dhe të shenjtë, urdhërit të Sulltanit-halife. U urdhëroi komandantëve ushtarakë në Shqipëri të mos e pengonin veprimtarinë e „Lidhjes”. Më në fund u premtoi shqiptarëve një farë autonomie nën sovranitetin e tij.⁵¹

⁴⁷ *Po aty*, 41, 42.

⁴⁸ *Muazere*: kërkesë, vendim, peticion, lutje, vendim i një Kuvendi.

⁴⁹ Jov. Hadži-Vasiljević, *vep. e cit.*, 42, 46, 47. Kjo vizitë është bërë, gjithsesi, para 13 qershorit 1878, sepse, përfaqësuesve shqiptarë nuk iu lejua që të merrnin pjesë zyrtarisht në Kongresin e Berlinit, ku diskutohesh për copëtimin e territoreve shqiptare.

⁵⁰ Jov. Hadži-Vasiljević, *vep. e cit.*, 42, 43.

⁵¹ Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë, 1939, 17, 18.

Sulltani-halife pati sukses ta formojë Fraksionin Prosulltan, apo Fraksionin Proislamik, të cilin e shpalli si „Lidhje Shqiptare”, sepse, ky emër, tashmë, kishte marrë famë të madhe. Kjo u bë me nxitim, më 10 qershor 1878, në një tubim të „Kuvendit të Lidhjes”, ende pa u mbledhur të gjithë deputetët e ftuar, respektivisht akoma pa u grumbulluar të gjithë përfaqësuesit e të gjitha viseve të Shqipërisë për *Kuvendin e Përgjithshëm të Lidhjes*, i cili do t’ia fillon punës më 17 qershor 1878. Domethënë kjo punë u bë, dy ditë para se t’ia fillonte punës Kongresi i Berlinit, me qëllim që t’ia tërhiqte vëmendjen opinionit ndërkombëtar dhe atij të vendit kah „Lidhja Shqiptare” e formuar nga vetë Sulltani-halife. Kështu, u veprua, pra, në radhë të parë për ta kompromitur Lidhjen Shqiptare të Haxhi Ymer Prizrenit; për ta demaskuar Programin e Lidhjes Shqiptare, të paraqitur para Kongresit të Berlinit, të cilin e sollën përfaqësuesit e saj të vërtetë, Abdyl Frashëri dhe Jani Vreto; për t’ia ndërruar karakterin e Lidhjes nga ai kombëtar, revolucionar, në atë islamik, konzervativ; për të krijuar një konfuzion, nga i cili, sot e kësaj dite, nuk jemi në gjendje të dalim, nuk jemi në gjendje, prandaj, ta kristalizojmë Lidhjen Shqiptare prej Fraksionit të Lidhjes Shqiptare.

Lidhur me *Kuvendin* e 10 qershorit 1878, dijetarja ruse, I. G. Senkeviç, duke u mbështetur në të dhënat e Qeverisë Serbe, të Jovan Ristiçit, konkludon:

„Më 10 qershor 1878, duke qenë shumica e delegatëve shqiptarë akoma në rrugë, në një xhami të Prizrenit hapet kuvendi, me ç’rast solemnisht shpallet krijimi i Lidhjes së Prizrenit. Pjesëmarrësit aktiv të kuvendit të parë të Lidhjes ishin bejlerët dhe pashallarët e pasur nga Bosnja, Sanxhaku i Jeni Pazarit, Maqedonisë dhe nga disa krahina të Bullgarisë, e poashtu edhe nga nëpunësit turqë të atyre krahinave”.⁵²

Pra, kuptojmë, se *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, respektivisht *Komiteti Qendror i Lidhjes* me Haxhi Ymer Prizrenin në krye, gjegjësisht *Këshilli Kryesor i Kuvendit*, po ashtu me Haxhi Ymerin në krye, e kishte ftuar *Kuvendin e Përgjithshëm të Lidhjes*, i cili duhej ta luante rolin e *Asamblesë Kushtetuese* ku duhej të miratoheshin aktet themelore të *Lidhjes*, të *Qeverisë Shqiptare*, e cila ishte në formim e sipër; ku duhej të miratohej *Kushtetuta e Shtetit Shqiptar*, si akt themelor i shtetit autonom shqiptar që do të krijohet; ku duhej të miratoheshin edhe organet e tjera qeveritare; ende pa u mbledhur përfaqësuesit (deputetët) e të gjitha viseve, Sulltani nxitoi, nëpërmjet të organeve të veta dhe të përfaqësuesve të vet që i kishte deleguar vetë, që në një Kuvend, i cili, zatën nuk ishte Kuvend i Lidhjes, ta shpalli solemnisht krijimin e „Lidhjes Shqiptare” të Prizrenit, por fraksioniste. Në këtë plan të përgatitur mirë pati sukses, sepse, në këtë Kuvend

⁵² I. G. Senkeviç, *Albania v period Vostočnogo krizisa*, Moskva, 1965, 104.

të „Lidhjes” dominonin përfaqësuesit e Sulltanit. Në këtë mbledhje nuk morën pjesë shumë përfaqësues — anëtarë të Lidhjes Shqiptare, të Komitetit Qendror të saj, si Abdyl Frashëri, Jani Vreto, të cilët gjendeshin në Berlin, e si duket, as Haxhi Ymer Prizreni. Përkundrazi morën pjesë shumë përfaqësues të fesë islame nga Bosnja, dhe nga viset e tjera të Ballkanit, d.m.th. përfaqësues joshqiptarë. Kështu, u soll para aktit të kryer *Lidhja Shqiptare, Komiteti Qendror* i saj dhe *Këshilli Kryesor i Kuvendit*, dhe vetë *Kuvendi i Përgjithshëm i Lidhjes*, i cili do t'ia fillon punës pas një jave. Para aktit të kryer u gjend i gjithë opinioni. Por, mu prej këtij çasti, për *Lidhjen Shqiptare të Vërtetë* hapet edhe një front lufte, fronti i brendshëm, fronti më i rrezikshëm, fronti i *Fraksionit Prosulltan, Proislamik*. Prej kësaj kohe, pra, i kemi dy Lidhje, me të njejtin emër: *Lidhja e Prizrenit, Lidhja Shqiptare e Prizrenit*. Dallimi në mes të tyre ishte vetëm te rruga, vetëm të binarët mbi të cilat ato ecnin, vepronin, jetonin, e luftonin.

Në Kuvendin e 10 qershorit 1878, sipas Süleyman Külçes, pa e treguar burimin, kishin marrë pjesë 43 përfaqësues, prej të cilëve 38 pjesëtarë të besimit mysliman dhe 5 të krishterë. Tubimi ishte mbajtur në „Bajrakli Xhami”, në Prizren. Prej pjesëmarrësve të Kuvendit përmendën: Shaip aga nga Prizreni, myftiu Zejnelabedin efendiu nga Prishtina, Zija Prishtina, Iljaz pashë Dibra nga Jeni Pazari, myftiu dhe Ejup beu, nga Shkupi, Jashar beu i Madhi, nga Tetova, Mehmet pashë Derala, Hasan pasha dhe sheh Mustafa, nga Gjakova, Abdullah pasha dhe Mustafa Vokshi, nga Kumanova, Ismail efendiu, nga Sjenica Spahoviqi, nga Peja Haxhi Zeka, nga Luma Ahmet aga, nga Mitrovica Osman efendiu, nga Ohri Sinan efendiu, pastaj Abdyl Frashëri, Akif pasha Elbasani, etj.⁵³

Në këtë listë të pjesëmarrësve nuk figuron emri i Haxhi Ymerit të Prizrenit. Kjo, ndoshta, tregon se ai nuk kishte marrë pjesë, ose, edhe në qoftë se kishte asistuar në këtë mbledhje, nuk ka mundur të luaj farë roli pozitiv, prandaj, edhe nuk është cekur. Përsa i përket Abdyl Frashërit me siguri nuk ka marrë pjesë, për arsye se ai, siç theksuam më sipër, është dashur të ishte, në atë kohë në Berlin. Por emri i tij është përmendur në këtë histori të Süleyman Külçes më parë për arsye se autori i librit ka paramenduar se tubimi nuk ka mundur të mbahej pa Abdylin, ngase ishte, anëtar i Lidhjes: kudo ishte, kudo shihej, kudo vepronte, kudo ndikonte. S. Külçeja, gjithsesi, e ngatërron pjesëmarrjen e Abdylit në Kuvendin e 10 qershorit me pjesëmarrjen e tij në *Kuvendin e Përgjithshëm të Lidhjes*, i cili ia filloi punës më 17 qershor. Mbledhjen e Kuvendit të 10 qer-

⁵³ Süleyman Külçe, *Osmanlı Tarihinde Arnavudluk*, Izmir, 1944, 249, 250.

shorit, ashtu si të gjithë autorët tjerë edhe te Süleyman Külçeja, por pa baza shkencore, e konsideron si *Kuvend të Përgjithshëm të Lidhjes*.

Mirëpo, në listën e pjesëmarrësve figurojnë edhe Ilijas pashë Dibra, sheh Mustafa nga Tetova dhe Abdullah pasha nga Gjakova, figura këto që janë edhe nënshkruese të dy dokumenteve të Fraksionit, të Kararnamës dhe të Talimatit. Ndërkaq, nënshkrues të këtyre dokumenteve nuk janë asnjë prej udhëheqësve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të Vërtetë: Haxhi Ymeri, Abdyl Frashëri, Haxhi Zeka, Shaip Spahiu, Sylejman Vokshi, etj. Sheh Mustafa, para se të hapej Kuvendi i 10 qershorit, e kishte vizituar Sulltanin. Pastaj, siç na bëjnë me dije burimet angleze, Abdullah pasha ishte, në fillim, kryetar i Fraksionit Prosulltan, e pas vrasjes së tij kryetar i Fraksionit bëhet sheh Mustafa.⁵⁴ Për figurën e Iljas pashës do të bëjmë fjalë më vonë.

Por, meqë Kuvendit të 10 qershorit, i kishte dhënë publicitet edhe Sulltani, edhe Porta e Lartë, edhe organet e tjera osmane, kësaj mbledhjeje i kanë dhënë popullaritet edhe diplomatët qëllimkëqij, edhe shtypi i huaj, edhe shkrimet osmane, etj. Pastaj, kanë konkluduar se Lidhja Shqiptare e Prizrenit u formua në Kuvendin e Lidhjes të mbajtur më 10 qershor 1878; se formimin e Lidhjes e kishte përkrahur Sulltani vetë, si politikisht, ashtu edhe financiarisht; se Lidhja ishte pjellë e Sulltanit dhe instrument i tij, etj. Nën ndikimin e këtyre shkrimeve, fatkeqësisht, kanë qenë edhe shumë shkencëtarë shqiptarë, e çka është akoma më keq, disa prej historianëve shqiptarë ende nuk duan të heqin dorë nga konceptonet e vjetra, por thonë: Shpallja e formimit të Lidhjes Shqiptare u bë solemnisht, më 10 qershor 1878, në „Kuvendin e Përgjithshëm të Lidhjes”, që është mbajtur në „Bajrakli Xhami”; se udhëheqësit e parë të Lidhjes Shqiptare ishin Iljas pashë Dibra, sheh Mustafa, Abdullah pashë Dreni, etj.; se aktet kryesore të Lidhjes Shqiptare ishin Kararnameja, Talimati, etj. Pra, edhe 10 qershori është marrë si datë jubilarë e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ani pse, siç pamë dhe siç do të shohim, 10 qershori është vetëm datë e formimit të Fraksionit Prosulltan apo Proislamit të Lidhjes, e jo datë e formimit të Lidhjes Shqiptare të Vërtetë, të Haxhi Ymer Prizrenit, e të Abdyl Frashërit.⁵⁵

Kështu, pra, lidhur me formimin e Fraksionit Prosulltan të Lidhjes, diplomati francez në ambasadën franceze në Stamboll, Ed. Engelhard dhe totullari i lartë i administratës osmane të asaj kohe Ali Reshadi, shkruajnë: Marrëveshja e Paqes së Shën-Stefanit parashihte formimin e Bullgarisë së Madhe, e cila duhej

⁵⁴ Public Record Office, London, F. O. 424/79, pp. 164-169.

⁵⁵ Hollësisht mbi këto çështje shih monografinë time, të cilën po e boton Enti i Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Kosovës, me titull: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1877-1885)*.

të shtrihej deri të Liqeni i Ohrit, Pastaj, Mali i Zi dhe Serbia, sipas Paqes, duhej të merrnin disa krahina të Shqipërisë Veriore. Prandaj shqiptarët u shqetësuan dhe rezistuan. Porta e Lartë, ndërkaq, për shkak të presionit të madh të Rusisë, shqiptarët i qetësonte, e fshehurazi i nxitte për të rezistuar. Duke u ndihmuar nga nëpunësit civilë dhe ushtarakë shqiptarë të veriut gradua-lisht dhe botërisht u përgatitën për rezistencë. Ata formuan edhe një *Lidhje (Bir cem'iyyet teşkili ettiler)*. Udhëheqësit e kësaj Lidhjeje ia dhanë *titullin e pashës* (Abdullah pasha). Në të vërtetë udhëheqjen e Lidhjes ia besuan njeriut të vendit. Në Prizren u formua një *Këshill Qendror, Udhëheqësi Qendror, Komitet Qendror* (Heyet-i Merkeziyye), kurse në sanxhaqe formohen degët (*su'be*).⁵⁶ Pra, Fraksioni Prosulltan u formua mu sipas principeve organizative të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të haxhi Ymer efendiut dhe të Abdyl be Frashërit. Prandaj, mu prej këtij çasti lindin ngatërresat në klasifikimin e Lidhjes prej „Lidhjes”, në dallimin e udhëheqësve të vërtetë të Lidhjes (Haxhi Ymeri, Abdyl Frashëri, Sylejman Vokshi, mulla Zeka, etj.), prej udhëheqësve të Fraksionit të Lidhjes (Abdullah pasha, sheh Mustafa etj.).

Se *Lidhja Shqiptare e Prizrenit me Komitetin Qendror* në krye ekzistonte qysh heret, se vetë *Lidhja* ishte ajo fryma kreative e të gjitha manifestimeve politike të mëparshme, pra edhe e organizimit të *Kuvendeve të Lidhjes*, si dhe të *Kuvendit të Përgjithshëm të Lidhjes*, na flasin raportet konsullare angleze në Shkodër. Raporti i parë dhe i dytë është shkruar në gjuhën angleze, më 12 e 14 qershor 1878, e i nënshkruar nga vetë konsulli, Kirby Green, kurse i treti është shkruar në frengjishte, më 17 qershor 1878, e i nënshkruar nga zëvendës konsulli, shqiptari F. Summa. Përmbajtja e të tri raporteve është, pothuajse, e njëjtë. Në to thuhet: Në të vërtetë, më 10 qershor 1878 iu dërgua protesta Vezirit të Madh, e nënshkruar nga banorët e Podgoricës, Shkodrës, prej bajraktarëve të Malësisë dhe të Mirditës. Të nënshkruarit e peticionit deklaruan se nuk do të lejojnë kurrfarë copëtimi të territorit të tyre dhe se do të kundërshtojnë me armë dorëzimin e çdo territori — dhe kërkuan me telegrame që banorët e të gjitha krahinave shqiptare të Matit, të Dibriës, të Prizrenit, të Gjakovës, të Pejës, të Jeni Pazarit dhe të Gucisë t'i bashkohen *Lidhjes*. Në rast se ndonjë territor do t'i jepet Malit të Zi, përtej pozitive që i kanë tani, do të merren masat e sigurimit, dhe iu dërgua urdhëri i rreptë valiut të Shkodrës për të penguar një gjakderdhje. Jam i njoftuar se *Komiteti Shqiptar* i mbledhur në Prizren (10 qershor 1878), telegrafisht, kërkoi bashkimin me *Lidhjen*, duke i ftuar banorët e rrethit të Shkodrës që të

⁵⁶ Ed. Engelhard — Ali Reşat, *Türkiyye ve Tanzimat — Devlet-i Osmâniyye'nin Târîh Islâhâtî*, 1826-1882, Istanbul, 1328 H., 412.

dërgojnë dy përfaqësues, në Prizren ku do të mbliidhen përfaqësuesit e të gjitha krahinave të Shqipërisë.⁵⁷

Nga dokumentet në fjalë shihet qartë se në Prizren, pavarësisht nga fakti se më 10 qershor u formua Fraksioni Prosulltan, ekzistonte edhe *Komiteti Qendror i Lidhjes*, i cili, sikurse edhe më heret, kuvendonte dhe merrte vendime me karakter kombëtar; i ftonte përfaqësuesit e krahinave të ndryshme të Shqipërisë për *Kuvendin e Përgjithshëm*; protestonte kundër copëtimit të tokave shqiptare; i thirrte viset e ndryshme shqiptare që t'i bashkohen Lidhjes Shqiptare, e jo Fraksionit të Lidhjes, i cili tashmë u krijua në gjirin e tij.

Ftesës së Komitetit Qendror të Lidhjes Shqiptare filluan t'i përgjigjen. Më 10 qershor grupi (komiteti) i Shkodrës i telegrafoi Komitetit Qendror të Lidhjes se do t'i dërgojë për së shpejti delegatët e vet në Prizren, për në Kuvendin e Përgjithshëm.⁵⁸ Në qershor arritën në Prizren telegramet nga Selaniku⁵⁹ e Shkodra, në të cilat shkruante se ishin gati të pranojnë çdo vendim që do të merrte *Këshilli i Lartë i Lidhjes* (Këshilli Kryesor i Kuvendit të Lidhjes), apo Komiteti Qendror i Lidhjes. Komiteti Qendror i Lidhjes nga Prizreni iu përgjigj duke kërkuar dërgimin e përfaqësuesve të tyre për në Kuvendin e Përgjithshëm.⁶⁰

Ftesa e Komitetit Qendror kishte bërë jehonë të madhe në gjithë Shqipërinë. Prandaj, i gjithë populli i Shqipërisë, myslimanët dhe të krishterët bashkarisht, të qyteteve dhe të fshatrave të Prizrenit, të Shkupit, të Velesit (Köprülü), të Shtipit, të Koçanës, të Tetovës, etj., siç njohton Berkeri, — ishin të gatshëm për të rezistuar me armë rusët, serbët dhe bullgarët; ishin pajtuar që të mbliidhen në Prizren, dhe aty të bashkohen në një fuqi të fortë kundër një sulmi të pritur. Kështu afro 120.000 burra ishin të gatshëm për të luftuar, posa të dëgjonin vendimin e Kongresit të Berlinit në të mirë të qëllimeve ruse dhe sllave.⁶¹

Më 15 qershor 1878 Komiteti Qendror i Lidhjes së Prizrenit, i cili vepronte aktivisht në Prizren, i dërgoi një telegram Portës së Lartë, me anën e të cilit e njohtonte, se shqiptarët nuk do t'i nënshtrohen sundimit ruso-bullgar e serbo-malazez dhe se kishin vendosur të luftojnë, kurse Porta e Lartë e kishte për detyrë të interesohej për fatin e Shqipërisë në Kongresin e Berlinit.⁶²

Pastaj, në telegramin e 15 qershorit 1878, drejtuar Portës së Lartë, thuhet edhe kjo: „Në kohën kur atdheu na fton në shër-

⁵⁷ F. O. 195/1186; F. O. 424/71, pp. 174, 340, 341.

⁵⁸ Xhafer Belegu, *vep. e cit.*, 22.

⁵⁹ Selaniku ishte qendër e Vilajetit të Selanikut në kuadrin e të cilit përfshihej, në atë kohë, Shqipëria e Mesme. Prandaj është fjala për përfaqësuesit e Shqipërisë së Mesme. Më vonë, siç do të flasim, territori i Shqipërisë së Mesme ndahet nga Vilajeti i Selanikut dhe prej tij formohet Vilajeti i Manastirit.

⁶⁰ Xhafer Belegu, *vep. e cit.*, 20.

⁶¹ F. O. 424/74, pp. 335. Raporti i zëvendëskonsullit anglez në Selanik, Edward B. B. Barker, dt. 14 qershor 1878.

⁶² Xhafer Belegu, *vep. e cit.*, 21.

bim të tij, interesat personale qofshin mallkuar. Në *Lidhjen* tonë kemi vendosur që mos t'i nënshtrohemi fesë, por në radhë të parë të jemi shqiptarë".⁶³

Sipas konsullit Lippich banorët e Shkodrës dhe malësorët e të dy besimeve vendosën që t'i bashkohen Lidhjes së Prizrenit, duke i dërguar përfaqësuesit e vet në Kuvendin e Përgjithshëm, dhe kishin vendosur për të rezistuar kategorikisht kundër dhënies së tokave të Malit të Zi.⁶⁴

Po qe se, pra, nuk ka ekzistuar Lidhja Shqiptare, si organizatë politiko-ushtarake, deri më 10 qershor 1878, atëherë, para nesh, shtrohen edhe këto pyetje: Cila qe fuqia organizuese e gjithë aktivitetit politik e ushtarak deri më 10 qershor, për të cilën gjë bëmë fjalë, madje disa herë, më lart?! Kush i ftoi dhe i organizoi kuvendimet në Prizren, të cilat, siç pamë, nuk ia filluan më 10 qershor 1878, por në maj të vitit 1878, si kuvendime botërisht?! Nëse Lidhja Shqiptare e Prizrenit, d.m.th. nëse Lidhja Shqiptare e Vërtetë e Haxhi Ymer Prizrenit dhe e Abdyl Frashërit është formuar në Kuvendin e Lidhjes të mbajtur më 10 qershor 1878, pse, atëherë, Haxhi Ymeri nuk përmendet, në asnjë dokument, jo vetëm si kryetar i Lidhjes, por, madje, as si pjesëmarrës i kuvendit në fjalë?! Në rast se është kështu, atëherë, kur dhe ku u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Komiteti Qendror i saj me Haxhi Ymerin në krye? Cili qe, pra, dokumenti i themelimit të Lidhjes Shqiptare dhe i Komitetit Qendror të saj, si organ ekzekutiv i Lidhjes?!

Nuk do mend se, 10 qershori 1878, nuk është datë e formimit të Lidhjes së Haxhi Ymerit, e as Kararnameja si akt i themelimit të saj. Kuvendi i 10 qershorit 1878, u udhëhoq nga mytesarifi i Prizrenit. Ky personalitet, në burimet tona të shfrytëzuara për këtë rast, njihet jo vetëm si autor i Kararnamës, i Talimatit, por edhe si krijues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më drejtë si krijues i Fraksionit Prosulltan, Proislamit të Lidhjes. Në të vërtetë, shqiptarët nuk kishin ra në atë pozitë sa të prisnin që një mytesarif turk, ta organizojë Lidhjen dhe ta hartojë aktin e themelimit të Lidhjes, Kararnamën, deri sa i kishin udhëheqësit e vet, të cilët ishin si intelektualisht, ashtu edhe politikisht e moralisht shumë më të ngritur se sa mytesarifi i Prizrenit. A nuk ishte në gjendje t'i bënte këto punë Haxhi Ymer Efendiu i Prizrenit, i cili qe myderriz, myfti, sheh me sarrëk të madh dhe mjekër të gjatë, si deputet i Parlamentit Osman; a nuk ishte në gjendje t'i kryejë këto punë Abdyl Frashëri, i cili kishte një kulturë shumë të lartë evropiane dhe orientale, ishte jurist modern evropian e ishte orator pashoq dhe diplomat i shquar; a nuk

⁶³ S. Kullçe, *vep. e cit.*, 250.

⁶⁴ „Leka” No. 10-12, Shkodër, 1938, 547; dt. 15 qershor 1878. Mbi „Veprimtarinë anti-kombëtare të Fraksionit Prosulltan të Lidhjes” shih kaptinën me këtë titull në monografinë time „Lidhja Shqiptare e Prizrenit”.

mund t'i bënte këto punë Pashko Vaso, i cili i fliste gjuhët evropiane dhe gjuhët orientale, ishte diplomat, shkrimtar e shkencëtar, ishte zëvendës vali (mysteshar) i Vilajetit të Kosovës. Të gjithë këta udhëheqës shqiptarë dhe anëtarë të Lidhjes Shqiptare, me veprimtarinë e tyre patriotike të deriatëhershme, kishin arritur autoritet shumë të madh në masat shqiptare. Vetëm burrat e tillë siç ishin ata, kanë mundur t'i mbledhin shqiptarët; vetëm prijatarët e tillë kanë mundur të themelojnë Lidhjen, si organizatë dhe si pushtet; vetëm njerëzit e tillë kanë qenë në gjendje të hartojnë dokumente me karakter kombëtar shqiptar, e kurrësi një turk, një mytesarif.

Në të vëntetë mytesarif i Prizrenit, duke u mbështetur në autoritetin e Sulltanit, pastaj, duke u mbështetur në sheh Mustafën e Tetovës, të cilin e kishte pranuar tanimë Sulltani në këshillim, dhe duke u mbështetur edhe në disa bejlerë shqiptarë labilë, të cilët morën pjesë në Kuvendin e 10 qershorit 1878, në të cilin, ende pa u tubuar të gjithë përfaqësuesit e ftuar shqiptarë, dominonte elementi prosulltanist, e shpall, në mënyrë solemne formimin e „Lidhjes Shqiptare”, u mor vesh, jo formimin e Lidhjes Shqiptare, të Haxhi Ymerit dhe të Abdyl Frashërit, por të Abdullah be-pashë Drenit,⁶⁵ të sheh Mustafës etj., pra, të Fraksionit.

Ndonëse u krijua Fraksioni Prosulltan, Lidhja Shqiptare e Haxhi Ymerit dhe i Abdyl Frashërit me Komitetin Qendror të saj, nuk e ndërpreu punën e vet. Ajo, përkundrazi, vazhdoi të veprojë, bile, jo veç në të njëjtën mënyrë, e për të njëjtin qëllim, siç veproi edhe më parë, pra, siç veproi deri më 10 qershor, por intenzitetin e veprimtarisë së vet e shtoi akoma më shumë. Sepse, prej tani, puna e saj u vështirësua; sepse, prej tani, asaj i duhej të luftonte edhe kundër Fraksionit, i cili, me veprimtarinë e vet fraksioniste përpiquej ta nxjerrte prej binarëve të vet Lidhjen Shqiptare; sepse, qysh tani, i duhej të luftonte haptazi edhe kundër Portës dhe Sulltanit, që ndiqnin një politikë anti-shqiptare.

Komiteti Qendror i Lidhjes Shqiptare i haxhi Ymerit dhe i Abdyl Frashërit organizohej vazhdimisht, bile, tani, edhe si pushtet kombëtar shqiptar, i cili ishte fuqizuar aq shumë, sa që, si i tillë, organizonte tubime, organizonte kuvendime, shkruante peticione, protesta, memorandume, statute e kushtetuta, dhe ato ua drejtonte për aprovim si Portës së Lartë, ashtu edhe Fuqive të Mëdha të Evropës.⁶⁶

⁶⁵ Abdullah be Dreni nga Gjakova deri te formimi i Lidhjes Shqiptare Fraksioniste (10 qershor 1878) quhej be, kurse prej asaj kohe, meqë u zgjodh për kryetar të saj, e mori titullin e pashës. Mirëpo, siç dihet, Abdullah pashë Dreni u vra, së bashku me Mehmet Ali pashën, të deleguarin e Sulltanit për sendërtimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, në shtator të vitit 1878. Këta u vranë nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

⁶⁶ *Vërejtje! Jeta dhe veprimtaria politiko-patriotike e Abdyl Frashërit (1878-1892) do të vazhdojë edhe në disa numra të ardhshëm të kësaj reviste.*

Në bazë të të gjithave që u tha përfundojmë se Abdyl Frashëri kishte një kulturë shumë të gjerë. Kishte kulturë orientale dhe evropiane. Fliste shumë gjuhë të huaja. Ishte jurist. Shkenctat juridike i kishte studiuar në Paris. Ishte diplomat i shquar shqiptar. Ishte gojëtar pashoq. Ishte revolucionar dhe largpamës.

Abdyl Frashëri ishte deputet i Parlamentit II Osman (1878). Ai ishte, pra, deputet më aktiv i Parlamentit. Me diskutimet e tij të zjarrta kërkoi, si një revolucionar, të bëheshin ndryshime të mëdha në të gjitha poret e jetës së Perandorisë Osmane.

Abdyl Frashëri, pra, kërkoi që arsimit në Perandorinë Osmane të modernizohet dhe të përparojë me një ritëm të shpejtë. Kërkoi që të hapen shkollat fillore dhe të mesme me plan-program evropian. Kërkoi formimin e Universitetit dhe të Akademisë së Shkencave, por moderne, siç ishin ato të Evropës.

Abdyl Frashëri e luftoi rreptë sistemin administrativ të Perandorisë Osmane. Në Parlament u ngrit kundër despotizmit, tiranisë dhe byrokracisë. U ngrit, pastaj, kundër nëpunësve analfabet, të cilët, zakonisht, zënin poste të larta në aparatit shtetëror. U ngrit kundër korrupsionit, dhe tarafeve. Ishte për atë, që administrimi i vendit t'u besohej njerëzve të shkolluar, njerëzve të aftë, njerëzve të denjë dhe të moralshëm. Pra, Abdyl, ishte për një sistem shoqëror demokratik, vetëqeverisës dhe internacionalist. Me një fjalë Abdyl ishte për një shtet me kushtetutë, ku të gjithë popujt e tij, pa marrë parasysh përkitjen e tyre kombëtare apo fetare, të ishin të barabartë në çdo pikëpamje.

Abdyl Frashëri, mandej, si një nga anëtarët më të spikatur të Lidhjes Shqiptare, luftoi për autonominë e Shqipërisë. Luftoi, prandaj, për një Shqipëri autonome apo të pavarur. Luftoi për një Shqipëri të bashkuar, për një Shqipëri demokratike dhe republikane. Luftoi për marrëdhënie vëllazërore dhe miqësore me të gjithë popujt e Ballkanit.

Skënder Rizaj

ABDYL FRASHËRI'S LIFE AND POLITICAL-PATRIOTIC ACTIVITY UP TO CONGRESS OF BERLIN (1878)

Summary

Abdyl Frashëri (Abdoul Phraschari) was born in 1839 in Frashëri, Albania, of a noble family. It is not a very common phenomenon that from a family to come out three leaders, three ardent patriots, as the three

Frashëri brothers were — Abdyl (1839-1892), Naim (1846-1900), Sami (1850-1904).

Abdyl Frashëri had got a very broad education. He had got Oriental and European education. He spoke many foreign languages, and was also famous as a jurist. He studied science of law in Paris. He was a prominent Albanian diplomat, a great orator, a revolutionist and far-sighted man.

Abdyl Frashëri was deputy of the Second of the Ottoman Assembly (1878). He was, consequently, the most active and energetic deputy of the Assembly, who, by his fiery, ardent discussions demanded the great changes to be done into the whole sphere of the Ottoman Empire's life.

In other words Abdyl Frashëri claimed that educational system in Ottoman Empire to be modernized and to make progress by a quick rhythm. He also demanded for elementaries and secondaries schools to be opened according to European plan and programme, formation of a modern University and for an Academy of Arts and Science, as those of Europe were.

Abdyl Frashëri strictly struggled the administrative system of the Ottoman Empire. He, in the Assembly, got up against despotism, tyranny and bureaucracy. Thereupon, he got up against ignorant civil servants, who, usually, were in the high post of the government machinery. He got up against corruption and against groups. He was for that the administration of the state to be conferred to educated persons, to capable, worthy, affable and morally people. Well, Abdyl was for a democratic, self-management and international society system. We may well say that Abdyl was for a constitutionally state where all people, of it, without regarding national and religious belonging, would be on an equal footing in every way.

Hereafter Abdyl Frashëri, as one of the most well-known members of the Albanian League, struggled for autonomy of Albania. Accordingly, he struggled for an autonomy or independence of Albania. He struggled for the unity Albania, for a democratic and republikan Albania. He struggled for brotherly and friendly terms between all people of the Balkans.

